



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.Dh.Sh.II.nr.478/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Tobler Skele shpk me seli në Prishtinë, i cili përfaqësohet sipas prokurës avokati Alban Makolli, ndaj debitorit Enerco LLC shpk me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2470/22 të datës 29.12.2023, me datë 05.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Tobler Skele shpk me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2470/22 të datës 29.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2470/22 të datës 29.12.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Enerco LLC shpk me seli në Prishtinë, ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr.613//2022 të datës 31.10.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilir Mulhaxha në Prishtinë, duke përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka ushtruar ankesë kreditori Tobler Skele shpk nga Prishtina, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, shkeljes se LPP-së, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, ankesën e kreditorit ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe Aktvendimin KPPP.nr.2470/22 dt.29.12.2023 ta Ndryshoj ashtu që ta Refuzoj prapësimin e ushtruar nga debitori dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor P.nr.613/22 dt.31.10.2022

Përgjigje në ankesë ka parashtruar i autorizuari i debitorit, me propozim që Dhomat e Shkallës së Dytë ta refuzojnë ankesën e kreditorit si të pabazuar dhe aktvendimin KPPP.nr.455/22 të datës 28.07.2023 ta vërtetoj.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Tobler Skele shpk me seli në Prishtinë, me datën 31.10.2022 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit Enerco LLC shpk me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.201210001 dt.20.10.2021 për shumën e borxhit prej 6,335.30 €.

Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.613/2022 të datës 31.10.2022 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës nr.2019210001 të datës 20.10.2021 me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ja paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumën prej 6,335.30€, me kamatë vjetore prej 8% sipas LMD-së dhe shpenzimet e procedurës së përmbartimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2470/22 të datës 29.12.2023 me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit debitorit Enerco LLC shpk me seli në Prishtinë, ka anuluar Urdhrin Përmbartimor P.nr.613//2022 të datës 31.10.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha në Prishtinë, duke përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se dokumenti – Faturës lëndore i mungon nënshkrimi dhe vula e debitorit, dhe e-mailit i mungojnë të dhënat e sakta në konfirmimin e debitorit se e ka pranuar faturën lëndore, gjykata konstaton se fatura nuk është pranuar asnjëherë nga debitori. Nuk ka prova se debitori ka pranuar faturën dhe rezulton se fatura është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori, si rezultat i kësaj ven deri te mungesa e tipareve të përmbartueshmërisë së dokumentit të besueshëm. Gjykata ka dhënë arsyetimet edhe ndaj pretendimeve në prapësim të debitorit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkalles së Dytë, vlerëson se gjykata e Shkallës së Parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se fatura e lëshuar nga ana e kreditorit është lëshuar në mënyrë të njëanshme dhe nuk përmbanë as vulën as nënshkrimin e pranuesit, respektivisht nuk dëshmohet pranimi i rregullt i faturës, e as nuk përcaktohet koha e

përmbushjes. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par.3 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmba- rim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmba- rimore, respektivisht është lejuar përmba- rimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë komulative qe duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret është edhe qëndrim i kësaj gjykate se qartë rezulton se fatura nuk është e nënshkruar dhe vulosur nga ana e pranuesit – debitorit dhe e njëjta nuk ka dëshmi se është pranuar në mënyrë të rregullt, ashtu që propozimi për përmba- rim nuk i plotëson kushtet nga Neni 37 i LPP-së.

Rrjedhimisht, kjo gjykatë vlerëson se nisur nga fakti se procedura përmba- rimore paraqet procedurë formale që i nënshtrohet shqyrtimit formal të dokumenteve përmba- rimore dhe/apo atyre të besueshme, rrjedh se si kusht esencial mbi bazën e së cilës mund të lejohet përmba- rimi janë tiparet e përmba- rueshmërisë së dokumentit të besueshëm e të cilit në rastin konkret i mungojnë kushtet nga Neni 29 par.3 dhe 37 i LPP-së. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmba- ruar sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmba- rimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmba- rimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Dhomat e shkallës së dytë nuk i aprovoi si të bazuara pretendimet ankimore se e-maili i datës 20.10.2021 është provë që dëshmon se debitori ka pranuar faturën nr.201021001 dt.21.10.2021, sepse ky dokument e-mail elektronik që gjendet në lëndë nuk konfirmon pranimin e faturës nga debitori.

Andaj, duke marr parasysh edhe pretendimet tjera ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimit, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmba- rimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.478/24 datë 05.07.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha